

DEKRET
Nr.7364, datë 24.3.1990

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJE E DEKRETE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.4407, datë 25.6.1968 "Për pyjet", bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë i nenit 5 ndryshohet si më poshtë:

"Pyjet me sipërfaqe deri në 10 ha mund të hiqen nga fondi pyjor me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit përkatës, dhe, kur sipërfaqja është më e madhe, me urdhër të ministrit të Bujqësisë".

- Paragrafi i dytë i nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

"Me vendimi të komiteit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit mund të lejohet shfrytëzimi i materialit drusor pa pagesë".

Neni 2

Në ligjin nr.5592, datë 5.6.1977 "Për shërbimin ushtarak në forcat e armatosura të RPSSH", bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i fundit i nenit 11 ndryshohet si më poshtë:

"Ministri i Mbrojtjes Popullore dhe ministri i Punëve të Brendshme kanë të drejtë të thërrasin oficerë, nënoficerë, ushtarë, rezervistë, paraushtarakë e vullnetarë për të kryer kurse të shkurtra për përgatitjen e kualifikimin ushtarak, si dhe të caktojnë kohëzgjatjen e tyre".

- Paragrafi i parë i nenit 13 ndryshohet si më poshtë:

"Studentët e shkollave të larta me shkëputje nga puna e kryejnë stërvitjen ushtarake gjatë vitit shkollor, kurse djemtë, pas mbarrimit të studimeve, kryejnë një kurs të përgatitjes ushtarake, koha e të cilit caktohet nga Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe Ministria e Arsimit".

Neni 3

Në dekretin nr.4743, datë 30.9.1970 "Për doganat", paragrafi i dytë i nenit 1 ndryshohet si më poshtë:

"Degët dhe zyrat doganore krijohen nga Ministria e Financave".

Neni 4

Në dekretin nr.4993, datë 10.10.1972 "Për krijimin e Akademisë së Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

- neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Institucionet kërkimore-shkencore dhe qendrat e studimit që hyjnë në përbërjen e Akademisë së Shkencave, caktohen nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Komisionin e Planit të Shtetit".

- Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Miratimi i statutit dhe i buxhetit të Akademisë së Shkencave bëhet nga Këshilli i Ministrave, kurse plani tematik me problemet kryesore miratohet nga Akademia e Shkencave".

Neni 5

Dekreti nr.5339, datë 23.9.1975 “Për ndërtimin e emrave dhe të mbiemrave të papërshtatshëm”, shfuqizohet.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi më 1 prill 1990.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia